



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 285, datë 06.07.2021

PËR
HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËME PËLQIM
NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË DHE SHPALLJEN E
KËRKESËS PËR KANDIDATURA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61 dhe në shkronjën “c”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 5, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë, për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një pozicion të lirë.
3. Afati i paraqitjes së kërkesave për transferim të përkohshëm është deri më datë 16.07.2021.
4. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente :
 - a) Kërkesën për shprehjen e interesit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë;
 - b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
 - c) Fotokopjen e kartës së identitetit;
 - ç) Deklaratën “Për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm” sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi;
 - d) Vetëdeklarimin për mospasjen masë disiplinore në fuqi, zbatimi i të cilës mund të shmanget për shkak të transferimit, sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi;
 - dh) Vetëdeklarimin për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi.
5. Dokumentacioni sipas pikës 4 të këtij vendimi, duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Informacion për kriteret dhe kohëzgjatjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim

6. Kriteret e transferimit të përkohshëm me pëlqim janë si më poshtë:
 - a) Transferimi i përkohshëm nuk duhet të cenojë funksionimin e gjykatës ku kandidati ka caktimin e përhershëm;
 - b) Dobia e transferimit të përkohshëm duhet të jetë më e madhe se efekti negativ që shkaktohet në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;
 - c) Kandidati nuk duhet të jetë i transferuar përkohësisht ose duke shërbyer në skemën e delegimit;
 - ç) Kandidati nuk duhet të jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të përkohshëm;
 - d) Kandidati nuk duhet të gjendet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
7. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim është deri në një vit. Ky transferim mund të përsëritet.
8. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim mund të përfundojë para afatit:
 - a) me kërkesë të gjyqtarit të transferuar përkohësisht, për shkaqe të justifikuara;
 - b) kur vazhdimi i transferimit të përkohshëm do të passillte cenim të funksionimit të gjykatës ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;
 - c) kur dobia e transferimit të përkohshëm është më e vogël se efekti negativ i shkaktuar në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;
 - ç) kur ndaj gjyqtarit të transferuar përkohësisht merret masë disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të tij;
 - d) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht jep dorëheqjen nga statusi i magjistratit;
 - dh) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht largohet nga detyra.
9. Për shqyrtimin e kërkesave për transferim të përkohshëm me pëlqim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ndjek procedurën e përcaktuar në Vendimin e tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar.
10. Transferimi i përkohshëm me pëlqim i gjyqtarit bëhet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

DEKLARATË
PËR
DHËNIE PËLQIMI PËR TRANSFERIM TË PËRKOSSHËM

Unë _____, aktualisht gjyqtar/e pranë Gjykatës _____, me vullnetin tim të lirë, mbështetur në nenin 46 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shpreh pëlqimin tim për transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, sipas Vendimit nr. 285, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lëshuar më _____.____.2021

DEKLARUESI

(Emri, atësia, mbiemri)
(Nënshkrimi)

VETËDEKLARIM

PËR MASA DISIPLINORE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, sipas Vendimit nr. 285, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk kam masë disiplinore në fuqi, zbatimi i të cilës mund të shmanget për shkak të transferimit.

Lëshuar më __. __. 2021

DEKLARUESI

(*Emri, atësia, mbiemri*)

(*Nënshkrimi*)

VETËDEKLARIM

PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, sipas Vendimit nr. 285, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk do të ndodhem në situatën papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lëshuar më ____ . ____ .2021

DEKLARUESI

(*Emri, atësia, mbiemri*)

(*Nënshkrimi*)